



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 32, Datë 28.02.2019

MBI

**MIRATIMIN E “PROPOZIMIT TË TË GJITHË OST-VE PËR NJË METODOLOGJI
PËR KOORDINIMIN E ANALIZAVE TË
SIGURISË SË OPERIMIT NË PËRPTHJE ME NENIN 75 TË RREGULLORES SË
KOMISIONIT TË BASHKIMIT EVROPIAN (BE) 2017/1485 TË DATËS 2 GUSHT
2017, QË PËRCAKTON NJË UDHËZUES MBI OPERIMIN E SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 7, nenit 16, nenit 53 dhe nenit 63 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 75 të “Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485, të datës 2 Gusht 2017, nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 28.02.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, për miratimin e propozimit të të gjitha OST-ve për një metodologji për koordinimin e analizave të sigurisë së operimit në përputhje me nenin 75 të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2017/1485 të datës 2 Gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “OST” sh.a. me shkresën nr. 7997 Prot., datë 20.11.2018, ka përcjellë në ERE për miratim “Propozimet e të gjithë OST-ve për një metodologji për koordinimin e analizave të sigurisë së operimit në përputhje me nenin 75 të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2017/1485 të datës 2 Gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”.
- ERE me Vendimin e Bordit nr. 253, datë 11.12.2018, filloi procedurën për miratimin e “Propozimit të të gjithë OST-ve për një metodologji për koordinimin e analizave të sigurisë së operimit në përputhje me nenin 75 të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2017/1485 të datës 2 Gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”.
- ERE në vijim të kësaj vendimmarrje dhe në zbatim të nenit 26, pikat 3 dhe 5 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, me shkresën nr.30/2 Prot., datë 06.02.2019, publikoi në median e shkruar njoftimin për fillimin e kësaj procedure dhe me shkresën nr. 35/2 Prot., datë 28.01.2019, ka njoftuar këtë vendim pranë palëve të

interesit, nga ku rezultoi që nuk kishte ndonjë koment apo opinion nga palët e interesuara.

- Kjo vendimmarrje është në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, përkatësisht nenit 56 dhe nenit 63, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në “Kodin e Transmetimit”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, përkatësisht neni 68 të "Metodologjisë për Koordinimin e Analizave të Sigurisë".
- Propozimet e të gjithë OST-ve për një metodologji për koordinimin e analizave të sigurisë së operimit, janë në përputhje me nenin 75 të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2017/1485, të datës 2 Gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike", si dhe dokumentin mbështetës mbi mënyrën e zbatimit të këtij propozimi, të përkthyer në shqip nga “OST” sha,

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë “Propozimet e të gjithë OST-ve për një metodologji për koordinimin e analizave të sigurisë së operimit në përputhje me nenin 75 të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2017/1485 të datës 2 Gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”.
2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie nga palët në interpretim të versionit shqip.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë palët e interesit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
ERJOLA SADUSHI

Propozimet e të gjithë OST-ve për një metodologji për koordinimin e analizave të sigurisë së operimit në përputhje me Nenin 75 të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

Ky dokument, i ofruar nga të gjithë Operatorët e Sistemit të Transmisionit (OST), është propozimi i të gjithë OST-ve për metodologjinë e koordinimit të analizës të sigurisë së operimit në përputhje me nenin 75 të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 2 gusht 2017 për krijimin e një udhëzuesi për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

Të gjithë OST-të, duke marrë parasysh sa vijon:

Ndërkohë:

1. Ky dokument është një propozim i përbashkët i zhvilluar nga të gjithë Operatorët e Sistemit të Transmetimit (më poshtë referuar si "OST-të") në lidhje me zhvillimin e një propozimi për një Metodologji për koordinimin e analizës së sigurisë së operimit (në vijim referuar si "Propozimi i CSA-së" ose "Metodologjia").
2. Kjo metodologji merr parasysh parimet dhe qëllimet e përgjithshme të përcaktuara në Rregulloren e Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 2 gusht 2017 për krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike (në vijim referuar si: "SO GL") si dhe 2015/1222 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e konxhestionit (në vijim referuar si "Rregullorja 2015/1222") dhe Rregullorja (KE) Nr 714/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 13 korrik 2009 mbi kushtet për aksesin në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike (më poshtë referuar si "Rregullorja (KE) Nr 714/2009"). Qëllimi i SO GL është të mbrojë sigurinë e operimit, cilësinë e frekuencës dhe përdorimin eficient të sistemit të interkonektuar dhe burimeve. Për të lehtësuar këto synime, është e nevojshme të përmirësohet standartizimi i analizës së sigurisë së operimit të paktën për zonën sinkrone. Standartizimi do të arrihet përmes një metodologjie të përbashkët për koordinimin e analizës së sigurisë operative.

Neni 75 i SO GL përbën bazën ligjore për Propozimin e CSA-së dhe përcakton disa kërkesa specifike që duhet të përfshijnë të paktën: (a) metodat për vlerësimin e ndikimit të elementeve të sistemit të transmetimit dhe SGU-ve të vendosura jashtë zonës së kontrollit të OST-së në mënyrë që të identifikohen ata elementë të përfshirë në zonën e vëzhgimit të OST dhe pragjet e ndikimit të kontigjencave mbi të cilat kontigjencat e këtyre elementeve përbëjnë kontigjenca të jashtme; (b) parimet për vlerësimin e përbashkët të riskut, duke mbuluar të paktën, rastet e kontigjencave të referuara në nenin 33: (i) probabiliteti i lidhur; (ii) mbingarkesat e pranueshme kalimtare; dhe (iii) ndikimi i kontigjencave; (c) parimet për vlerësimin dhe trajtimin e paqartësive të gjenerimit dhe ngarkesës, duke marrë parasysh një kufi besueshmërie në përputhje me Nenin 22 të Rregullores (EU) 2015/1222; (d) kërkesat për koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit midis koordinatorëve të sigurisë rajonale në lidhje me detyrat e renditura në nenin 77 (3); (e) roli i ENTSO për Energjinë Elektrike në qeverisjen e mjeteve të përbashkëta, përmirësimin e rregullave të cilësisë së të dhënave, monitorimin e metodologjisë për analizën e koordinuar të sigurisë së operimit dhe dispozitave të përbashkëta për koordinimin rajonal të sigurisë së operimit në secilin rajon të llogaritjes së kapaciteteve.

3. Duke marrë parasysh nevojat efektive për standartizim, Propozimi i CSA-së gjithashtu përmban dispozita: (i) të identifikojë veprimet korrigjuese që duhen të jenë të koordinuara midis OST-ve dhe të lehtësojë koordinimin eficient të veprimeve korrigjuese në nivel rajonal në përputhje me metodologjinë rajonale që do të zhvillohet më vonë nga të gjitha OST-të e një rajoni të llogaritjes së kapaciteteve sipas Nenit 76 (1) (b) të SO GL; (ii) të sigurojë realizimin eficient të analizave të sigurisë së operimit për afate kohore të ndryshme sipas neneve 72 deri 74 të SO GL; dhe (iii) të sigurojë zbatimin eficient dhe në

kohë i vlerësimit të relevancës së aseteve të koordinimit të ndërprerjeve në përputhje me metodologjinë sipas nenit 84 të SO GL dhe koordinimin e nevojshëm të saj me metodën e llogaritjes së influencës së përbashkët sipas nenit 75 (1) (a) të SO GL.

4. Në përputhje me Nenin 84 (3) të SO GL, dispozitat e Propozimit të CSA-së, në lidhje me përkufizimin e metodës së llogaritjes së influencës së përbashkët në pajtim me nenin 75 (1) (a), janë të përafuara me metodën e llogaritjes së influencës së përbashkët të përcaktuar në propozimin e metodologjisë për Vlerësimin e Aseteve të Koordinimit të Ndërprerjeve e zhvilluar sipas Nenit 84 (1) të SO GL.
5. Referuar Nenit 6 (6) të SO GL, duhet të përshkruhet impakti i prituri i Propozimit të CSA-së mbi objektivin e SO GL, siç është paraqitur në vijim. Propozimi i CSA-së përgjithësisht kontribuon në arritjen e objektivave të SO GL. Në veçanti, Propozimi i CSA-së shërben si objektiv i ruajtjes së sigurisë së operimit në të gjithë Unionin, veçanërisht koordinimi i operimit të sistemit dhe planifikimit të operimit; transparenca dhe besueshmëria e informacionit mbi operimin e sistemit të transmetimit; dhe operimi eficient i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike në Unionin.
6. Për më tepër, Propozimi i CSA-së siguron zbatimin e parimeve të proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit; transparencës; optimizimit midis efikasitetit të përgjithshme më të lartë dhe kostos totale më të ulët për të gjithë palët e përfshira; dhe përdorimin e mekanizmave të bazuara në treg sa më shumë të jetë e mundur, për të siguruar sigurinë dhe qëndrueshmërinë e rrjetit.
7. Në përfundim, Propozimi i CSA-së do të kontribuojë në objektivat e përgjithshme të SO GL në dobi të të gjitha OST-ve, Agjencisë, autoriteteve rregullatore dhe pjesëmarrësve të tregut

Në vijim parashtrohet Propozimi i CSA-së për të gjitha autoritetet rregullatore.

PJESA I

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Lënda dhe qëllimi

1. Metodologjia e përshkruar në këtë propozim është propozimi i përbashkët i të gjitha OST-ve në përputhje me Nenin 75 të SO GL.
2. Kjo metodologji do të mbulojë koordinimin e analizës së sigurisë së operimit në nivel Evropian dhe zbatohet për të gjitha OST-të, RSC-të, OSSh-të, OSMSH-të dhe SGU-të siç përcaktohet në Nenin 2 të SO GL.
3. OST-të nga juridiksionet jashtë zonës së përmendur në Nenin 2 (2) të SO GL mund të marrin pjesë në koordinimin e analizës së sigurisë së operimit në baza vullnetare, me kusht që:
 - a) për ta bërë këtë të jetë teknikisht e realizueshme dhe në përputhje me kërkesat e SO GL;
 - b) ata bien dakord se do të kenë të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi në lidhje me koordinimin e analizës së sigurisë së operimit si OST-të e përmendura në paragrafin 2;
 - c) ata pranojnë çdo kusht tjetër që lidhet me natyrën vullnetare të pjesëmarrjes së tyre në koordinimin e analizës së sigurisë së operimit që OST-të e përmendur në paragrafin 2 mund të vendosin;
 - d) OST-të e përmendura në paragrafin 2 kanë lidhur një marrëveshje që rregullon kushtet e

pjesëmarrjes vullnetare me OST-të e përmendura në këtë paragraf;

- e) Pasi OST-të që marrin pjesë në koordinimin e analizave të sigurisë së operimit në baza vullnetare kanë demonstruar pajtueshmëri objektive me kërkesat e përcaktuara në (a), (b), (c) dhe (d), dhe OST-të e përmendura në paragrafin 2 pasi të kenë kontrolluar që kriteret në (a), (b), (c) dhe (d) janë plotësuar, miratojnë një aplikim nga OST që dëshiron të marrë pjesë në baza vullnetare në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 5 (3) të SO GL
4. OST-të e përmendura në paragrafin 2 do të monitorojnë nëse OST-të që marrin pjesë në koordinimin e analizës së sigurisë së operimit në baza vullnetare në përputhje me paragrafin 3, i respektojnë detyrat e tyre. Nëse një OST që merr pjesë në koordinimin e analizës së sigurisë së operimit sipas paragrafit 3 nuk i respekton detyrat e tij thelbësore në një mënyrë që rrezikon ndjeshëm zbatimin dhe funksionimin e SO GL, OST-të e referuara në paragrafin 2 do të ndërpresin pjesëmarrjen vullnetare të OST-së në procesin e koordinimit të analizës së sigurisë së operimit në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 5 (3) të SO GL.

Neni 2

Përkufizimet dhe interpretimi

1. Për qëllimet e këtij propozimi, termat e përdorur do të kenë kuptimin e përkufizimeve të përfshira në nenin 3 të SO GL, nenit 2 të Rregullores 2015/1222 dhe pikat e tjera të legjislacionit të referuar. Përveç tyre, do të përdoren edhe përkufizimet më poshtë:

“Ngarkesë referencë” nënkupton ngarkesën mesatare të përcaktuar si energjia totale e konsumit në zonën e kontrollit e pjestuar me numrin e orëve që përbëjnë vitin.

“Faktori i rritjes së ngjarjes së përhershme” nënkupton një faktor që shpjegon një rritje të përhershme të probabilitetit të ndodhjes së një kontigjence të jashtëzakonshme.

“Faktori i rritjes së ngjarjes së përkohshme” nënkupton një faktor që shpjegon një rritje të përkohshme të probabilitetit të ndodhjes së një kontigjence të jashtëzakonshme.

“Kontigjencë në zhvillim” nënkupton humbjen e disa elementëve të rrjetit dhe/ose përdoruesve të rrjetit si rezultat i ndodhjes së një kontigjence nga lista e kontigjencave, e ndjekur nga fikja automatike ose manuale e elementëve shtesë të rrjetit të cilat janë në kundërshtim me kufijtë e tyre të sigurisë operationale.

“Kontigjenca me zhvillim të kontrolluar.” nënkupton një kontigjencë në zhvillim për të cilën mund të simulohet çdo hap pasues i kontigjencës fillestare derisa të arrihet një gjendje e qëndrueshme.

“Veprim korigjues parandalues” nënkupton një veprim korigjues që është rezultat i një procesi planifikimi operacional dhe është i nevojshëm të aktivizohet afatit kohor të shqyrtuar për pajtueshmërinë me kriterin (N-1)

“Veprim korigjues përmiresues” nënkupton një veprim korigjues që është rezultat i një procesi planifikimi operacional dhe aktivizohet menjëherë pas ngjarjes së kontigjencës përkatëse për pajtueshmërinë me kriterin (N-1), duke marrë parasysh mbingarkesat tranzitore të lejueshme dhe kohëzgjatjen e tyre të pranueshme.

“Veprim korigjues i restaurimit” nënkupton një veprim korigjues që aktivizohet pas ndodhjes së një gjendje alarmi për rikthimin e sistemit të transmetimit përsëri në gjendje normale.

“Grup veprimesh korigjuese” nënkupton një kombinim të veprimeve korigjuese që duhet të aktivizohen në tërësi për të ruajtur sigurinë e operimit.

“Ndikimi ndërkuftar” nënkupton efektin në lidhje me ndryshimin e flukseve të fuqisë ose të tensionit në një interkoneksion ose një element të sistemit të transmetimit që ndodhet jashtë zonës së kontrollit të OST që rezulton nga aktivizimi i një veprimi korigjues në zonën e kontrollit të OST-së.

“Faktori i influencës së veprimit korigjues” nënkupton një vlerë numerike që përdoret për të përcaktuar ndikimin ndërkuftar të një veprimi korigjues ose të një grupi veprimesh korigjuese.

"Veprim korigjues me ndikim ndërkuftar" nënkupton një veprim korigjues, që konsiderohet të aktivizohet nga një OST dhe aktivizimi i të cilit ka një ndikim të rëndësishëm në të paktën një OST që nuk është i përfshirë në aktivizimin e tij.

"Veprim korigjues me ndikon ndër-RSC" nënkupton një veprim korigjues me ndikim ndërkuftar, që konsiderohet të aktivizohet nga një OST i cili ka deleguar detyrat në një RSC të caktuar në përputhje me Nenin 77 (3) të SO GL dhe aktivizimi i të cilit ka një ndikim domethënës në të paktën një OST që nuk është i përfshirë në aktivizimin e tij dhe i cili ka deleguar detyrat në një RSC tjetër në përputhje me Nenin 77 (3) të SO GL.

"Veprimi korigjues i dakortësuar" nënkupton një veprim korigjues me rëndësi ndërkuftare sipas Nenit 35 të Rregullores 2015/1222 ose një veprim korigjues me ndikim ndërkuftar për të cilin të gjitha OST-të e prekura kanë dhënë pëlqimin e tyre për aktivizimin e këtij veprimi korigjues në sistem, kur të jetë e nevojshme. Para aktivizimit të tij, një veprim i tillë korigjues pritet të jetë i nevojshëm bazuar në analizat e sigurisë të kryera gjatë planifikimit operacional.

"OST e deleguar" do të thotë një OST e cila i ka deleguar detyrat në një RSC në përputhje me Nenin 77 (3) të SO GL

Vlerësim rajonal paraprak nënkupton një analizë të sigurisë së operimit të kryer nga një OST për të përgatitur një model individual të rrjetit.

'Analiza e koordinuar e sigurisë së operimit' nënkupton një analizë të sigurisë së operimit e kryer nga një OST mbi një model të rrjetit të përbashkët, në përputhje me Nenin 72 (3) dhe 72 (4) të SO GL.

'Vlerësimi i koordinuar rajonal mbi sigurinë e operimit' nënkupton një analizë të sigurisë së operimit të kryer nga një RSC mbi një model të rrjetit të përbashkët, në përputhje me Nenin 78 të SO GL

2. Atje ku kjo metodologji i referohet elementëve të rrjetit, në të përfshihen edhe sistemet HVDC

3. 'MIRr' dhe 'MPRr' respektivisht qëndrojnë për 'modelin individual të rrjetit' dhe 'modelin e rrjetit të përbashkët'. "NRA" qëndron për "autoritetin rregullator kombëtar". 'ENTSO-E' qëndron për 'ENTSO për energjinë elektrike'. 'RSC' qëndron për 'koordinatorin rajonal të sigurisë'

Përcaktimi i elementeve influencues

Kapitulli 1

Përcaktimi i faktorit të influencës

Neni 3

Metoda e llogaritjes së influencës

1. Metoda e llogaritjes së influencës ka karakteristikat e mëposhtme:
 - a) Është në gjendje të karakterizojë ndikimin e mungesës së një elementi të rrjetit të lidhur me rrjetin e OST ose OSSh/OSMSh në fluksin e fuqisë ose tensionit të një elementi tjetër të rrjetit të transmetimit;
 - b) Është i aplikueshëm në modelet e rrjetit të përbashkët të një viti në avancë, të zhvilluara në përputhje me Nenin 67 të SO GL ose në modelin e rrjetit të OST-ve me përfaqësimin e sistemeve të OSSh/OSMSh.
 - c) Influenca karakterizohet në lidhje me vlerën relative ose absolute të flukseve të fuqisë ose ndryshimit të tensionit dhe rezultati është në gjendje të krahasohet kundrejt pragjeve.
2. Çdo OST do të zbatojë metodën e llogaritjes së influencës të dhënë në Shtojcën I për llogaritjen e faktorëve të influencës së flukseve të fuqisë në zonën e tij të kontrollit të elementëve të rrjetit që ndodhen jashtë zonës së kontrollit të OST dhe të lidhur me një sistem transmetimi.
3. Çdo OST duhet të zbatojë metodën e llogaritjes së influencës, të dhënë në Shtojcën I, për llogaritjen e faktorëve të influencës së flukseve të fuqisë në zonën e tij të kontrollit të elementëve të rrjetit të lidhur me elementët e rrjetit të OSSh/OSMSh të lidhura në transmetim që ndodhen jashtë zonës së tij të kontrollit, me kusht që ato të jenë modeluar në MPRr-të e përdorura për llogaritje.
4. Kur një OST pret që llogaritja e faktorëve të influencës së flukseve të fuqisë në zonën e tij të kontrollit nuk do të kapë mjaftueshëm elementët e rrjetit që mund të shkaktojnë ndryshime të konsiderueshme të tensionit në zonën e tij të kontrollit, kjo OST do të ketë të drejtë të përdorë faktorët e influencës së tensionit në përcaktimin e zonës së tij të vëzhgimit dhe listën e kontigjencave të jashtme.
5. Aty ku është e zbatueshme sipas paragrafit 4, secili OST duhet të informojë OST-të e prekur për vendimin për të llogaritur faktorët e influencës së tensionit dhe duhet të zbatojë metodën e llogaritjes së influencës të dhënë në Shtojcën I për llogaritjen e këtyre faktorëve të elementëve të rrjetit që ndodhen jashtë zonës së tij të kontrollit dhe të lidhur me një sistem transmetimi.
6. Aty ku është e zbatueshme sipas paragrafit 4, secili OST duhet të zbatojë metodën e llogaritjes së influencës të dhënë në Shtojcën I për llogaritjen e faktorëve të influencës së tensionit të elementëve të rrjetit të lidhur në rrjetet OSSh/OSMSh të lidhura në transmetim që ndodhen jashtë zonës së tij të kontrollit. OST do të informojë OST-të në të cilat rrjetet OSSh-ve/OSMSh-ve të kyçura në transmetim janë të lidhura dhe ndikohen nga zbatimi i këtij paragrafi për vendimin e tij për të llogaritur faktorët e influencës së tensionit.
7. Çdo OST, në rrjetet e të cilave janë lidhur në transmetim OSSH/OSMSh që preken nga aplikimi i paragrafit 6, duhet t'i njoftojë këto OSSh-të/OSMSh-të të lidhura rreth këtij

aplikimi.

8. Çdo OST duhet të informojë OSSh-të/OSMSh-të e zonës së tij të kontrollit për vendimin për të llogaritur flukset e fuqisë dhe/ose faktorët e influencës së tensionit të elementëve të rrjetit të sistemeve të tyre dhe do të ketë të drejtë t'i kërkojë informacion OSSh-ve/OSMSh-ve për parametrat teknikë dhe të dhënat me një intesitet të arsyeshëm të kufizuar në proporcionalitet me nevojat e llogaritjes së influencës, me qëllim që të lejojë përfshirjen e të paktën një pjesë të rrjeteve të tyre në modelin e rrjetit të OST.
9. Kur kërkohet sipas paragrafit 8, secili OSSh/OSMSh do t'i ofrojë OST një grup të vetëm koherent të dhënash brenda tre muajve pas marrjes së kërkesës, për t'i mundësuar OST-s së lidhur të përfshijë pjesën e kërkuar të rrjetit të tyre në modelin e vet të rrjetit ose në rrjetin e tij individual të krijuar sipas paragrafit 12.
10. Secili OST duhet të përdorë modelet e rrjetit të përbashkët të krijuara sipas Nenit 67 të SO GL dhe të plotësuara sipas nevojës në përputhje me paragrafin 12, kur llogariten faktorët e influencës së flukseve të energjisë dhe/ose tensionit të elementëve të rrjetit të lidhur direkt ose përmes një OSSh/ OSMSh në një zonë kontrolli tjetër të OST-së
11. Kur llogaritet influenca e elementëve të rrjetit të vendosur në rrjetet e OSSh/OSMSh që janë të lidhura me zonën e tij të kontrollit, për të përcaktuar nëse ato janë pjesë e zonës së tij të vëzhgimit, secili OST do të përdorë modelet e rrjetit të përbashkët të krijuara sipas Nenit 67 të SO GL, ose modelin e rrjetit të vet; në të dyja rastet, këto modele do të plotësohen sipas nevojave të paragrafit 8.
12. Çdo OST do të përfshijë në modelin e tij individual të rrjetit modelin përkatës të të dhënave të OSSh/OSMSh të lidhur në transmetim, të cilin e identifikon si të nevojshëm për llogaritjen e faktorëve të ndikimit nga një OST tjetër.

Neni 4

Rëndësia e mundshme e aspekteve dinamike për vlerësimin e influencës

1. Kur një OST duhet të zbatojë nenin 38 (6) (b) ose nenin 38 (6) (c) të SO GL për të siguruar një operim të sigurt të sistemit të tij të transmetimit, kjo OST do të ketë të drejtë të kërkojë mbështetjen e OST-ve të interesuara të cilat përdorin studime dinamike për vlerësimin e influencës së elementëve të rrjetit, modulet gjeneruese të energjisë dhe objektet e kërkesës që ndodhen jashtë zonave të tyre të kontrollit dhe të lidhura me një sistem transmetimi. Në këtë rast, kjo OST dhe OST-të e interesuara do të përcaktojnë modele, studime dhe kritere që do të përdoren për vlerësimin dhe do të informojnë NRA-të e tyre për marrëveshjen e tyre. Këto modele dhe studime duhet të jenë në përputhje me ato të zhvilluara në zbatim të Neneve 38 ose 39 të SO GL
2. Kur një OST duhet të zbatojë nenin 38 (6) (b) ose nenin 38 (6) (c) të SO GL për të siguruar një operim të sigurt të sistemit të tij të transmetimit, kjo OST do të ketë të drejtë të përdorë studime dinamike për të vlerësuar influencën e elementëve të rrjetit, modulet gjeneruese të energjisë dhe objektet e kërkesës së vendosura në rrjetet e lidhura në transmetim të OSSh/OSMSh të lidhur në këtë OST. Në një rast të tillë, OST duhet të përdorë modele, studime dhe kritere, në përputhje me ato të zhvilluara në zbatim të Neneve 38 ose 39 të SO GL.

3. Kur një OST duhet të zbatohet nën 38 (6) (b) ose nën 38 (6) (c) të SO GL për të siguruar një operim të sigurt të sistemit të tij të transmetimit, ky OST ka të drejtë të kërkojë mbështetjen e OST-ve të interesuara për të përdorur studime dinamike për vlerësimin e influencës së elementëve të rrjetit, modulet gjeneruese të energjisë dhe objektet e kërkesës të vendosura në rrjetet e OSSH-ve/OSMSh-ve të lidhura me OST të tjera. Në një rast të tillë, OST që kryen llogaritjen do të informojë OST-të, në të cilat janë lidhur në transmetim OSSh-të/OSMSh-të, në lidhje me këtë vendim dhe duhet të përdorë modele, studime dhe kritere në përputhje me ato të zhvilluara në zbatim të Neneve 38 ose 39 të SO GL.
4. Çdo OST, në të cilin OSSh-të/OSMSh-të e lidhura në transmetim janë të lidhura dhe janë prekur nga aplikimi i paragrafëve 2 ose 3, duhet t'i informojë këto OSSh/OSMSh-të dhe SGU-të e interesuara të lidhura në këto OSSh/OSMSh rreth këtij vendimi për përdorimin e studimeve dinamike për të vlerësuar influencën e tyre dhe do të ketë të drejtë t'i kërkojë këtyre OSSh-ve/OSMSh-ve dhe SGU-ve parametrat dhe të dhënat teknike përkatëse, me kusht që kjo kërkesë të jetë proporcionale me nevojat e studimit dinamik.
5. Kur kërkohet sipas paragrafit 4, secili OSSh/OSMSh i lidhur në transmetim dhe çdo SGU do të ofrojë një grup të vetëm koherent të të dhënave brenda tre muajve pas marrjes të kërkesës për të mundësuar që OST e lidhur të përfshijë pjesën e kërkuar të sistemeve të tyre në modelet e zhvilluara në zbatim të Neneve 38 ose 39 të SO GL.
6. Çdo OST, në të cilin janë lidhur OSSh/OSMSh e lidhur në transmetim dhe që preken nga zbatimi i paragrafit 2 dhe 3, duhet të ndajë rezultatet e vlerësimit të kryer me OSSh/OSMSh e lidhur në transmetim dhe SGU-të e interesuara.
7. Kur një ose më shumë elementë janë identifikuar në zbatim të paragrafit 2, OST përkatës do të informojë NRA-në e tij mbi elementët e identifikuar me arsyetimin që mbështet këtë rezultat.
8. Kur një ose më shumë elementë janë identifikuar në zbatim të paragrafit 3, OST që ka kryer studimet dinamike dhe OST-të në të cilat janë lidhur OSSh/OSMSh e lidhura në transmetim, duhet të informojnë NRA-të e tyre për elementet e identifikuar me arsyetimin që mbështet këtë rezultat.

Kapitulli 2

Identifikimi i elementeve influencues

Neni 5

Identifikimi i elementëve të zonës së vëzhgimit

1. Çdo OST do të përcaktojë zonën e tij të vëzhgimit në përputhje me Nenin 3, Nenin 4 kur është e aplikueshme dhe paragrafët e mëposhtëm.
2. Çdo OST do të synojë të bjerë dakord me çdo OSSh/OSMSh të lidhur në transmetim të zonës së tij të kontrollit se cilat janë elementët e tyre të rrjetit të lidhura në këtë rrjet të OSSh/OSMSh që do të jenë pjesë e zonës së tij të vëzhgimit bazuar në vlerësimin cilësor.
3. Aty ku konsiderohet e nevojshme nga OST, ky OST do të synojë të bjerë dakord me çdo OSSh/OSMSh që nuk është e lidhur në transmetim në zonën e tij të kontrollit dhe OSSh-në e lidhur se cilat janë elementët e rrjetit të lidhur me këtë OSSh/OSMSh që do të jenë pjesë e zonës së tij të vëzhgimit bazuar në vlerësimin cilësor.

4. Nëse OST dhe OSSh/OSMSh e interesuar nuk bien dakord, identifikimi i elementeve do të bëhet në përputhje me Nenin 3 dhe aty ku është e mundur, Nenin 4.
5. Çdo OST duhet të zgjedhë vlerat e pragut brenda kufijve të pragjeve të vëzhgimit të renditura në Shtojcën 1 që do të përdorë për të përcaktuar zonën e vëzhgimit në zbatim të paragrafëve 6 dhe 7. Vlerat e pragut do të jenë identike pavarësisht elementit të rrjetit të cilit i vlerësohet influenca nga kjo OST. Çdo OST do t'i komunikojë ENTSO-E këto vlera të pragut në kohë me zbatimin e paragrafit 1 dhe në përputhje me Nenin 45 (10). ENTSO-E do të mbledhë këto vlera të pragjeve dhe do t'i publikojë në faqen e saj të internetit të paktën një herë në vit.
6. Çdo OST duhet të përfshijë në zonën e tij të vëzhgimit:
 - a) të gjithë elementët e rrjetit jashtë zonës së tij të kontrollit të cilat kanë një faktor influence më të madh se vlerat përkatëse të pragut të influencës së vëzhgimit të përzgjedhur sipas paragrafit 5;
 - b) të gjithë elementët e rrjetit të OSSH / OSMSh të lidhur në transmetim të zonës së tij të kontrollit, të identifikuar në përputhje me paragrafin 2 ose të gjithë elementët e rrjetit të OSSh-ve/OSMSh-ve të lidhura në transmetim të identifikuar në përputhje me paragrafin 4 që kanë një faktor influence më të madh se vlera përkatëse e pragut të influencës së vëzhgimit, zgjedhura sipas paragrafit 5;
 - c) të gjithë elementët e rrjetit të OSSH/ OSMSh-ve të lidhura në transmetim brenda zonës së tij të kontrollit, të identifikuar në përputhje me paragrafin 3 ose të gjithë elementët e rrjetit të OSSh-ve/OSMSh-ve të palidhura në transmetim të identifikuar në përputhje me paragrafin 4 që kanë një faktor influence më të madh se vlerat përkatëse e pragut të influencës së vëzhgimit të përzgjedhur sipas paragrafit 5;
 - d) të gjithë elementët e rrjetit që lidhin zonën e kontrollit të këtij OST me zonë e kontrollit të një OST tjetër.
 - e) elementët shtesë të rrjetit të cilat janë të nevojshme për të siguruar një zonë vëzhgimi plotësisht të lidhur;
 - f) elementët e identifikuar në zbatim të nenit 4(1) deri në nenin 4(3), aty ku është e zbatueshme;
 - g) zbarat për të cilat elementët e rrjetit të identifikuar më parë në përputhje me pikat a deri f mund të lidhen.
7. Një OST do të ketë të drejtën të nxjerrë nga puna disa elementë të rrjetit të identifikuar në përputhje me paragrafin 6(a) deri 6(c), në rast se faktori i tyre i influencës nuk është më i madh se vlera maksimale e diapazonit të kufijve të përcaktuar në Aneksin 1.
8. Në rast se OST synon të përfshijë në zonën e tij të vëzhgimit elementët e rrjetit, modulet gjeneruese të energjisë ose objektet e kërkesës që janë të lidhura në sistemin e transmetimit dhe nuk janë të lidhura në një zbarë të identifikuar në përputhje me paragrafin 6, ky OST do t'i dërgojë një kërkesë OST të interesuar. OST-të që marrin kërkesën kanë të drejtë ta pranojnë ose refuzojnë atë.
9. OST-të kanë të drejtë të pranojnë të mbajnë shkëmbimin ekzistues të të dhënave për elementët që nuk janë identifikuar në zbatim të paragrafit 6.
10. OST-të dhe OSSh-të kanë të drejtë të pranojnë të mbajnë shkëmbimin ekzistues të të dhënave për elementët që nuk janë identifikuar në zbatim të paragrafit 6.

11. Çdo OST do të rivlerësojë zonën e tij të vëzhgimit në përputhje me paragrafët 2 deri në 8 të paktën një herë në çdo 5 vjet.
12. Midis dy vlerësimeve të detyrueshme në përputhje me paragrafin 11, çdo element i ri i komisionuar brenda zonës së vëzhgimit të një OST duhet të përfshihet në zonën e tij të vëzhgimit. Nëse pronari i elementit të ri nuk pajtohet me një trajtim cilësor të tillë, OST-të do të përdorin metodën e llogaritjes së influencës në përputhje me Nenin 3 dhe Nenin 4, aty ku është e zbatueshme, për përcaktimin e rëndësisë së elementëve të tillë.

Neni 6

Identifikimi i kontigjencave të jashtme

1. Çdo OST do të përcaktojë listën e tij të kontigjencave të jashtme në përputhje me Nenin 3, Nenin 4 aty ku është e zbatueshme dhe paragrafët e mëposhtëm.
2. Çdo OST do të zgjedhë vlerat e pragut brenda kufijve të pragjeve të kontigjencave të jashtme të listuara në Aneksin 1 që duhet të përdorë për të përcaktuar listën e kontigjencave të jashtme në zbatim të paragrafit 1. Vlerat e pragut do të jenë identike, pavarësisht nga elementi i rrjetit, influenza e të cilit është vlerësuar nga ky OST. Çdo OST do t'i komunikojë ENTSO-E këto vlera të pragut në kohë në zbatim të paragrafit 1 dhe në përputhje me Nenin 45(10). ENTSO-E do të mbledhë këto vlera të pragjeve dhe do t'i publikojë në faqen e saj të internetit të paktën një herë në vit.
3. Çdo OST do të përfshijë në listën e tij të kontigjencave të jashtme të paktën:
 - a) të gjithë kontigjencat e një elementi të vetëm të rrjetit jashtë zonës së tij të kontrollit, të cilat kanë një faktor influence më të madh se vlerat korresponduese të pragut të kontigjencës të zgjedhur sipas paragrafit 2;
 - b) të gjitha kontigjencat e elementeve të rrjetit të vendosura në rrjetet e OSSH/OSMSh të lidhura në transmetim me këtë OST, të cilat ndodhen në zonën e vëzhgimit të OST dhe të dakortësuara zakonisht midis OST dhe OSSH/OSMSh sipas Nenit 5(2) ose të gjitha kontigjencat e elementeve të rrjetit e këtyre OSSH-ve dhe OSMSh-ve, të cilat ndodhen në zonën e vëzhgimit të OST-së dhe të cilat kanë një faktor influence më të madh se vlerat e pragut të kontigjencave të jashtme korresponduese të zgjedhura sipas paragrafit 2.
4. Çdo OST ka të drejtë të plotësojë listën e tij të kontigjencave të jashtme me secilin nga modulet gjeneruese dhe objektet e kërkesës të lidhura në një zbarë të identifikuar në përputhje me nenin 5.
5. Të gjithë elementët e rinj të komisionuar brenda zonës së vëzhgimit të një OST do të vlerësohen në përputhje me Nenin 3 dhe aty ku është e zbatueshme Nenin 4, ose do të përfshihen pa asnjë vlerësim në listën e kontigjencave të jashtme.

Çdo OST do të rivlerësojë listën e kontigjencave të jashtme në përputhje me paragrafët 2 deri në 4 të paktën një herë në 5 vjet.

Pjesa 3
Parimet e koordinimit
Kapitulli 1
Menaxhimi i kontigjencave të jashtëzakonshme
Neni 7
Klasifikimi i kontigjencave

1. Kur ndërton listën e tij të kontigjencave siç kërkohet nga Neni 33 i SO GL, çdo OST do të klasifikojë për zonën e tij të kontrollit:
 - a) Kontingjencat e mëposhtme si të zakonshme:
 - i. Humbja e vetëm një linje/kablllo.
 - ii. Humbja e vetëm një transformatori;
 - iii. Humbja e vetëm një transformatori fazor;
 - iv. Humbja e vetëm një pajisjeje të kompensimit të tensionit;
 - v. Humbja e vetëm një komponenti të një sistemi HVDC si një linjë ose një kablllo ose një njësi konvertuese HVDC e vetme;
 - vi. Humbja e vetëm një njësie gjeneruese të energjisë;
 - vii. Humbja e vetëm një objekti kërkese.
 - b) Kontingjencat e mëposhtme si të jashtëzakonshme:
 - i. Humbja e elementëve të rrjetit që kanë një modul të përbashkët gabimi, që do të thotë që një gabim i vetëm (si një defekt në një zbarë, sistemi i tokëzimit të HVDC, automatët, transformatorët e matjes ...) do të çojë në humbjen e më shumë se një elementi të rrjetit;
 - ii. Humbja e linjave ajrore të ndërtuara në të njëjtën shtyllë;
 - iii. Humbja e kablllove nëntokësore të ndërtuara në të njëjtin kanal;
 - iv. Humbja e përdoruesve të rrjetit që kanë regjim të përbashkët të procesit, që do të thotë se humbja e papritur ose e pjesshme e një përdoruesi të rrjetit do të çojë në humbjen totale ose të pjesshme të të tjerëve (p.sh: njësitë me ciklël të kombinuar)
 - v. Humbja e elementëve/përdoruesve të rrjetit të shkyçur njëkohësisht si rezultat i funksionimit të Skemës së Mbrojtjes Speciale;
 - vi. Humbja e njërive gjeneruese të shumëfishta (duke përfshirë parqet diellore dhe të erës) të shkëputura si pasojë e rënies së tensionit në rrjet.
 - c) Kontingjencat e mëposhtme si jashtë diapazonit:
 - i. Humbja e dy ose më shumë linjave të pavarura;
 - ii. Humbja e dy ose më shumë kablllove të pavarur;
 - iii. Humbja e dy ose më shumë transformatorëve të pavarur ose transformatorëve fazorë;
 - iv. Humbja e dy ose më shumë përdoruesve të pavarur të rrjetit (njësia gjeneruese e energjisë ose objekti i kërkesës);

- v. Humbja e dy ose më shumë pajisjeve të pavarura të kompensimit të tensionit;
 - vi. Humbja e dy ose më shume zbarave të pavarura;
 - vii. Humbja e dy ose më shumë komponentëve të pavarur të një sistemi HVDC siç janë linjat, kabllot ose njësitë konvertuese HVDC;
2. Për çdo lloj tjetër kontigjence që rezulton në humbjen e njëkohshme të një ose disa përdoruesve të rrjetit ose elementëve të rrjetit dhe nuk janë të listuara më sipër, secili OST do t'i klasifikojë ato në një nga tri kategoritë (të zakonshme, të jashtëzakonshme ose jashtë diapazonit) në përputhje me përkufizimet e parashikuara nga Neni 3 i SO GL.

Neni 8

Trajtimi i faktorëve të rritjes së ngjarjes

1. Çdo OST do të përcaktojë për çdo kontigjencë të jashtëzakonshme rëndësinë dhe kriteret e zbatimit të faktorëve të rritjes së ngjarjes të mëposhtëm:
- a) Faktorët e rritjes së ngjarjes së përhershme:
 - i. vendndodhjen gjeografike specifike,
 - ii. kushtet e projektimit
 - b) Faktorët e rritjes së ngjarjes së përkohshme:
 - i. kushtet operacionale
 - ii. kushtet meteorologjikt ose mjedisore
 - iii. jetëgjatësia ose mosfunksionimi xhenerik që ndikojnë në riskun e dështimit
2. Gjatë përcaktimit të rëndësisë dhe kriterëve të zbatimit të faktorëve të rritjes së ngjarjeve të renditura në paragrafin 1b, çdo OST do të marrë në konsideratë kushtet operacionale, meteorologjike ose mjedisore në lidhje me specifikimet dhe gjendjen aktuale të pajisjeve.
3. Gjatë përcaktimit të rëndësisë së zbatimit të faktorëve të rritjes së ngjarjeve të renditura në paragrafin 1, çdo OST duhet të marrë parasysh historikun e incidenteve që kanë ndodhur në elementët përkatës të rrjetin.

Neni 9

Kontigjencat e jashtëzakonshme me një risk të ndikimit të lartë në zonën e kontrollit ndërkufitare

1. Kur një OST pret që kontigjencat e jashtëzakonshme të ndodhura në zonën e kontrollit të një tjetër OST mund të sjellin në pasoja më tepër se pasojat brenda zonës së kontrollit të OST, të cilat konsiderohen si të pranueshme në lidhje me legjislacionin e tij kombëtar siç përmendet në Nenin 4(2)(e) të SO GL, ose nëse nuk ekziston ndonjë legjislacion kombëtar, në lidhje me rregullat e brendshme të tij dhe OST tjetër nuk i përfshin këto kontigjenca të jashtëzakonshme në listën e tij të kontigjencave sepse nuk identifikon faktorët e rritjes së ngjarjeve në përputhje me Nenin 8, këto OST mund të krijojnë së bashku një marrëveshje mbi kontigjencat e jashtëzakonshme shtesë që ndodhen në një nga zonat e tyre të kontrollit të cilat duhet të përfshihen në listat e tyre të kontigjencave me qëllim që të sigurojnë që pasojat në zonat e tyre të kontrollit të mbeten të pranueshme.
2. Gjatë krijimit të kësaj marrëveshjeje, këta OST do të përcaktojnë koston maksimale të

veprimeve korigjuese mbi të cilat kostoja e përmbushjes së limiteve të sigurisë së operimit nuk do të konsiderohet proporcionale me riskun, duke marrë parasysh legjislacionin e tyre kombëtar siç referohet në Nenin 4(2)(e) të SO GL, ose nëse nuk ekziston ndonjë legjislacion kombëtar, duke marrë parasysh rregullat e tyre të brendshme.

3. Gjatë krijimit të kësaj marrëveshjeje, këta OST duhet të sigurojnë që të gjitha OST-të e prekura të marrin pjesë në marrëveshje.

Neni 10

Krijimi i listës së kontigjencave

1. Në zbatim të Nenit 33(1) të SO GL, çdo OST duhet të përfshijë në listën e tij të kontigjencave:
 - a) kontigjencat e zakonshme;
 - b) kontigjencat e jashtëzakonshme që plotësojnë kriteret e zbatimit të të paktën një faktori të rritjes së ngjarjes së përhershme;
 - c) kontigjencat e jashtëzakonshme që plotësojnë kriteret e zbatimit të të paktën një faktori të rritjes së ngjarjes së përkohshme kur plotësohen kushtet;
 - d) kontigjencat e jashtëzakonshme që çojnë në pasoja më tepër se pasojat brenda zonës së kontrollit të OST, të cilat konsiderohen si të pranueshme në lidhje me legjislacionin e tij kombëtar siç referohet në Nenin 4(2)(e) të SO GL, ose nëse nuk ekziston legjislacion kombëtar, në lidhje me rregullat e tij të brendshme.
2. Përveç kësaj, secili OST pjesë e një marrëveshjeje të krijuar sipas Nenit 9 do të përfshijë në listën e tij të kontigjencës, aty ku është e nevojshme, kontigjencat e jashtëzakonshme të identifikuar.
3. Përveç kësaj, secili OST do të përfshijë në listën e tij të kontigjencave kontigjencat e jashtme të jashtëzakonshme që mund të rrezikojnë sistemin e tij nëse ato janë të përfshira përgjithmonë ose përkohësisht në një listë të kontigjencave të brendshme të një tjetër OST, sipas Nenit 11(1) dhe (4).
4. Gjatë vlerësimit të kontigjencave të përmendura në pikën a të paragrafit 1, secili OST ka të drejtë të përjashtojë ato që kurrë nuk do të çojnë në pasoja më tepër se pasojat që konsiderohen si të pranueshme në lidhje me legjislacionin e tij kombëtar ose nëse nuk ekziston një legjislacion kombëtar, në lidhje me rregullat e tij të brendshëm.
5. Gjatë vlerësimit të kontigjencave të përmendura në pikën d të paragrafit 1, secili OST do të marrë parasysh nëse kostoja e veprimeve korigjuese të nevojshme për të mbajtur pasojat e pranueshme konsiderohet proporcionale me riskun në lidhje me legjislacionin e tij kombëtar ose nëse nuk ekziston një legjislacion kombëtar në lidhje me rregullat e tij të brendshëm.

Neni 11

Shpërndarja e listës së kontigjencave

1. Secili OST do të informojë pa vonesa OST-të, zona e vëzhgimit e të cilave përmban elementë të rritjes së listës së tij të kontigjencave dhe RSC-të përkatëse për çdo përditësim të kontigjencave të jashtëzakonshme që plotësojnë kriteret e zbatimit të të paktën një faktori të rritjes së ngjarjes së përhershme.
2. Secili OST do të informojë pa vonesa OST-të, zona e vëzhgimit e të cilave përmban

elementë të rrjetit të listës së tij të kontigjencave për çdo përditësim të kontigjencave të jashtëzakonshme që kanë potencial për të përmbushur kriteret e zbatimit të të paktën një faktori të rritjes së ngjarjes së përkohshme.

3. Kur informohet nga një OST tjetër që një kontigjencë e jashtëzakonshme plotëson të paktën një faktor të rritjes së ngjarjes së përkohshme ose ka potencialin të plotësojë kriteret e zbatimit të të paktën një faktori të rritjes së ngjarjes së përkohshme, çdo OST do të vlerësojë nëse kjo kontigjencë do të rrezikojë rrjetin e tij.
4. Secili OST do të informojë pa vonesë OST-të, zona e vëzhgimit e të cilëve përmban elementë të rrjetit të listës së tij të kontigjencave dhe RSC-të përkatëse për çdo përditësim të kontigjencave të jashtëzakonshme kur plotësohen kushtet për përmbushjen e kriterëve të zbatimit të të paktën një faktori të rritjes së ngjarjes së përkohshme.
5. Çdo OST do të informojë pa vonesë, kur kushtet nuk plotësohen më, OST-të, zona e vëzhgimit e të cilëve përmban elementë të rrjetit të listës së tij të kontigjencave dhe RSC-të përkatëse për çdo përditësim të kontigjencave të jashtëzakonshme që nuk i përmbushin më kriteret e zbatimit të ndonjë faktori të rritjes së ngjarjes së përkohshme.
6. Çdo OST do të informojë RSC-të përkatëse për kontigjencat e listës së tyre të kontigjencave për të cilat OST nuk do të kërkohet që të pajtohet me kriterin (N-1) ose
 - a) sepse OST vendos që të mos pajtohet me kriterin (N-1) në zbatim të Nenit 35 të SO GL-së ose
 - b) sepse ata janë pjesë e grupit të kontigjencave të dakortësuara bashkarisht në zbatim të nenit 12.
7. Secili OST do të informojë RSC-të përkatëse lidhur me kontigjencat e identifikuar në zbatim të Nenit 9.

Kapitulli 2

Vlerësimi i pasojave të paparashikuara

Neni 12

Marrëveshje e përbashkët mbi pasojat e zonave ndërkufitare

1. OST-të do të kenë të drejtën që së bashku të bien dakord në një marrëveshje shumëpalëshe që një grup kontingjentesh në listat e tyre të paparashikuara nuk respektojnë kriterin (N-1). Parakushti për një marrëveshje të tillë shumëpalëshe është se kontigjencat që nuk respektojnë kriterin (N-1) kanë pasoja të kufizuara në zonat e kontrollit të OST-ve kontraktuese dhe konsiderohen si të pranueshme brenda secilës zone Kontrolluese të OST-së kontraktuese në lidhje me legjislacionin e tyre kombëtar siç u referohet në nenin 4 (2) (e) të SO GL ose, nëse nuk ekziston ndonjë legjislacion kombëtar, rregullat e tyre të brendshme. Këto OST-të do të informojnë të gjithë OST-të dhe RSC-të lidhur me këtë marrëveshje.

Neni 13

Vlerësimi i pasojave

1. Përveç Nenit 35 (1) të SO GL, secili OST do të vlerësojë pasojat e çdo kontingjenti të listës së tij të kontigjencave:

- a) duke vlerësuar se devijimi i energjisë midis gjenerimit dhe kërkesës që rezulton nga ndodhja e një kontigjence ose një kontigjence të evoluar të verifikueshëm nuk e tejkalon incidentin referues dhe se është plotësuar një nga kushtet e mëposhtme:
- i. kufijtë e sigurisë operacionale të përcaktuara sipas nenit 25 të SO GL respektohen në të gjitha elementet e rrjetit të zonës së saj të kontrollit në përputhje me Nenin 35 (1) të SO GL dhe nuk ka rrezik të krijoje një shqetësim në sistemin e transmetimit, ose
 - ii. ndodhja e paparashikuarit çon në një kontigjent evolues të verifikueshëm me pasoja të kufizuara në perimetrin e zonës së kontrollit të OST dhe konsiderohet si i pranueshëm në lidhje me legjislacionin e tij kombëtar siç përmendet në Nenin 4 (2) (e) të SO GL ose nëse asnjë legjislacion kombëtar nuk ekziston, në përputhje me rregullat e saj të brendshme, në përputhje me Nenin 35 (5) të SO GL
- b) ose duke vlerësuar, me mbështetjen e RSC-ve përkatëse aty ku është e zbatueshme, që devijimi i energjisë midis gjenerimit dhe kërkesës që rezulton nga ndodhja e një kontigjenti të evolueshëm të verifikueshëm nuk e tejkalon incidentin referues dhe se ndodhja e rastit të çon në pasojat e kufizuara në zonat e kontrollit të OST-ve të cilat janë palë në një marrëveshje të përcaktuar sipas nenit 12 dhe konsiderohen si të pranueshme brenda çdo zone kontrolli të OST-së në lidhje me legjislacionin e saj kombëtar siç referohet në Nenin 4 (2) (e) të SO GL ose , nëse nuk ekziston ndonjë legjislacion kombëtar, rregullat e tij të brendshme dhe nuk ka rrezik të përhapjes së një shqetësimi në pjesën tjetër të sistemit të transmetimit të ndërlidhur.

Kapitulli 3

Koordinimi i veprimeve përmirësuese

Neni 14

Ndikimi ndërkufitar i grupeve të veprimeve përmirësuese

1. Gjatë hartimit të një sërë veprimesh përmirësuese, OST-të do të vlerësojnë ndikimin ndërkufitar të të gjithë grupit dhe nuk do të vlerësojnë ndikimin ndërkufitar të secilës vepër korrigjuese elementare që përbën grupin.
2. Kur hartimi i përbashkët i një sërë veprimesh korrigjuese në zbatim të Nenit 20 dhe 78 të SO GL, OST-të do të marrin në konsideratë këtë grup veprash përmirësuese si ndikim ndërkufitar për ta.

Neni 15

Vlerësimi sasior i ndikimit ndërkufitar

1. Kur OST-të duhet të vlerësojnë në mënyrë sasiore ndikimin ndërkufitar të një veprimi korrigjues ose të një sërë veprimesh përmirësuese në përputhje me Nenin 16 (1), OST-të duhet të përdorin faktorin e ndikimit të veprimit përmirësues të përcaktuar nga devijimi maksimal i rrjedhës në interkonektorët e tyre të normalizuar nga ngarkesa e tyre e përhershme e pranueshme që rezulton nga zbatimi i një veprimi korrigjues ose i një sërë veprimesh korrigjuese.
2. Gjatë vlerësimit të faktorit të ndikimit të një veprimi korrigjues siç përshkruhet në paragrafin 1, OST-të kanë të drejtë të pajtohen, gjatë përgatitjes së propozimit për

metodologjinë për përgatitjen e veprimeve përmirësuese të menaxhuara në mënyrë të koordinuar sipas nenit 76 (1) (b) e SO GL, për elementet e jashtme shtesë të përfshira në zonën e tyre të vëzhgimit që do të konsiderohen përveç ndërlikohësve të tyre.

3. OST-të kanë të drejtë të bien dakord, gjatë përgatitjes së propozimit për metodologjinë për përgatitjen e veprimeve korrigjuese të menaxhuara në mënyrë të koordinuar sipas nenit 76 (1) (b) të SO GL, për të vlerësuar ndikimin ndërkufitar në bazë të ndryshimit e tensionit. Në këtë rast, OST-të do të bien dakord mbi listën e nyjeve ku do të bëhet vlerësimi i tillë.
4. Për veprimet korrigjuese parandaluese, ndryshimi i flukseve ose tensionit duhet të vlerësohet në situatën N dhe në secilën nga situatat N-1 që rezultojnë nga simulimi i listës së kontigjencave të paparashikuara. Për veprimet korrigjuese përmirësuese, ndryshimi i flukseve ose tensionit duhet të vlerësohet në simulimin e gjendjes pas emergjencës për të cilën është hartuar ky veprim korrigjues.
5. OST-të do të marrin në konsideratë veprimet korrigjuese ose grupet e veprimeve përmirësuese për të cilat faktori ndikues i veprimit korrigjues është më i lartë se një prag i pranuar zakonisht si ndikim ndërkufitar gjatë përgatitjes së propozimit për metodologjinë për përgatitjen e veprimeve përmirësuese të menaxhuara në mënyrë të koordinuar sipas Nenit 76 (1) (b) të SO GL.
6. Nëse nuk përcaktohet një prag i tillë, OST-të do të marrin në konsideratë veprimet korrigjuese ose grupet e veprimeve korrigjuese si ndikim ndërkufitar kur faktori ndikues i veprimit korrigjues të përcaktuar në paragrafin 1 është më i lartë se 5%.

Neni 16

Procesi për vlerësimin e ndikimit ndërkufitar

1. Gjatë përgatitjes së propozimit për metodologjinë për përgatitjen e veprimeve korrigjuese të menaxhuara në mënyrë të koordinuar sipas Nenit 76 (1) (b) të SO GL, duke përdorur një metodë cilësore ose sasiore ose një kombinim të tyre, të gjithë OST-të e secilit CCR së bashku do të përcaktojnë:
 - a) veprimet e mundshme korrigjuese ose grupet e veprimeve korrigjuese që konsiderohen ndikim ndërkufitar dhe OST-të përkatëse të prekura nga këto veprime korrigjuese. Për veprimet korrigjuese ose grupet e veprimeve korrigjuese që janë të përcaktueshme, si redispaçimi për menaxhimin e konxhestionit, ndryshimin e pikës së caktuar në sistemet HVDC ose ndryshimin e ancafkave në transformatorët fazë-shifter sasia mbi të cilën këto veprime përmirësuese ose grupe të veprimeve përmirësuese bëhen kryq do të përcaktohen ndikimet kufitare;
